

Strategjia për Bashkëpunim me Diasporën 2019-2023:

Etnocentrizëm i skajshëm maqedon në programin për shoqatat e diasporës



Përmbajtja

| | |
|--|---|
| HYRJE | 2 |
| STRATEGJIA NACIONALE PËR BASHKËPUNIM ME DIASPORËN 2019-2023 | 3 |
| FINANCIMI I PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË DIASPORËS | 4 |
| Projektet e vitit 2018 | 4 |
| Projektet e vitit 2019 | 5 |
| Marrja e plotë e mbikëqyrjes së programit për shoqatat e diasporës nga ana e MPJ-së: 2020-2023 | 5 |
| Projektet e vitit 2021 | 6 |
| Projektet e vitit 2022 | 6 |
| Projektet e vitit 2023 | 6 |
| KONKLuzion | 7 |
| REKOMANDIME | 9 |

Maqedonia e Veriut është vend emigracioni, me një diasporë shumë të madhe dhe gjithnjë në rritje. Megjithatë, askush nuk mund të thotë me saktësi numrin e saktë të qytetarëve që kanë emigruar jashtë vendit.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2021, të kontestuar në masë të madhe, vetëm 260.606 qytetarë të Maqedonisë së Veriut ishin emigrantë. Ky numër është tërësisht jo i besueshëm sepse ai është shumë më i ulët se të gjitha vlerësimet nga burimet ndërkombëtare. Sipas Bankës Botërore, numri i qytetarëve të Maqedonisë së Veriut që jetojnë jashtë vendit ishte 342.243 persona në vitin 2000, 447.138 në vitin 2010 dhe 626.312 persona në vitin 2013, me një trend të qartë të rritjes së vazhdueshme.

Megjithatë, edhe numrat e Bankës Botërore janë shumë larg realitetit. Zëvendëskryeministri Fatmir Bytyqi deklaroi në shtator të vitit 2022 se “nga viti 2011 deri në vitin 2019 nga vendi ynë janë larguar 700.000 qytetarë, ose çdo i katërti ka ikur nga shteti”. Nëse i mbledhim këto shifra me vlerësimet konservative të Bankës Botërore të vitit 2010 (447,138 emigrantë), bëhet e qartë se më tepër se një milion qytetarë të Maqedonisë së Veriut kanë emigruar, ose thuajse gjysma e popullsisë.

Megjithëse regjistrimi i popullsisë i vitit 2021 është krejtësisht jo i besueshëm për sa u përket numrave, ai megjithatë është një lloj treguesi të strukturës kombëtare të diasporës së vendit. Sipas rezultateve të regjistrimit, shqiptarët përbëjnë 66,36% të diasporës së Maqedonisë së Veriut. Pas tyre vijnë maqedonët me 24,45%, turqit me 4,79%, romët me 1,02%, vllahët me 0,19%, serbët me 0,35% dhe boshnjakët me 0,81%.

Diaspora luan një rol jetik në të gjitha fushat e jetës në Maqedoninë e Veriut, duke filluar nga zhvillimi ekonomik e deri te arsimit dhe kultura. Sipas Odës Ekonomike të Maqedonisë Veriperëndimore (OEMV), remitencat e mërgimtarëve luajnë rolin e stabilizatorit kryesor të politikave makroekonomike në vend: OEMV vlerëson se gjatë vitit 2015 diaspora ka sjellë rreth 1,5 miliard euro remitenca, apo 20% e Bruto Prodhimit Vendor.

Megjithatë, pavarësisht rëndësisë së saj për zhvillimin e vendit, diaspora është injoruar nga shteti që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, politika e qeverisë ndaj diasporës ka qenë çështje thellësisht e politizuar për shkak të strukturës kombëtare të diasporës, e dominuar nga shqiptarët. Për pasojë, deri në vitin 2019 qeveria nuk ka miratuar asnjëherë ndonjë udhërrëfyes politik për të mbështetur diasporën dhe për të shfrytëzuar potencialin e saj në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

STRATEGJIA NACIONALE PËR BASHKËPUNIM ME DIASPORËN 2019-2023

Më 5 mars 2019 Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ish ministrit përgjegjës për diasporën, Edmond Ademi, ka miratuar strategjinë e parë nacionale për bashkëpunim me diasporën (2019-2023) dhe planin e saj të veprimit. Kjo strategji është dokumenti i parë shtetëror që definon orientimet politike dhe veprimit e shtetit në lidhje me diasporën.

Strategjia bazohet në katër shtylla:

1. Çështjet politiko-juridike dhe konsullore
2. Diaspora dhe zhvillimi ekonomik
3. Arsimi, shkenca dhe rinia
4. Lidhjet kulturore, identiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore

Numri dhe kompleksiteti i fushave që mbulon kjo strategji nënkupton nevojën e përfshirjes së disa institucioneve, përgjegjësitë dhe kompetencat e të cilave janë përcaktuar në kuadër të strategjisë dhe planit të saj të veprimit, përfshirë ministritë, institucionet shtetërore, organizatat joqeveritare, profesorë universitarë, përfaqësues nga institucionet kulturore në vend, si dhe përfaqësues të organizatave nga diaspora.

Me shuarjen e Ministrisë së Diasporës pa portofol pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020 (edhe pse midis dhjetorit 2021 dhe shkurtit 2023 kjo ministri u riaktivizua për të akomoduar futjen e Alternativës në qeveri), zbatimi i strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën kaloi nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme, e cila ka qenë e obliguar të menaxhojë dhe financojë projektet me organizatat e diasporës për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj strategjie dhe të zbatimit të saj konkret, Instituti për Politika Publike (IPP) Arbën Xhaferi ka nisur deri te Sekretariai i Qeverisë dhe te Ministria e Punëve të Jashtme kërkesa për qasje në informata me karakter publik, duke kërkuar detajet e të gjitha projekteve me organizata nga diaspora të financuara në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën (2019-2023). Ky raport analizon të dhënat e dorëzuara nga Ministria, me shumë vonesa dhe pas shumë presioneve nga ana e Institutit.

FINANCIMI I PROJEKTEVE TË ORGANIZATAVE TË DIASPORËS

Organizatave dhe shoqatat e mërgimtarëve kanë rëndësi të madhe për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet diasporës dhe vendit të origjinës. Përfshirja e tyre në zbatimin e strategjisë është një ndër faktorët kryesorë përcaktues për suksesin e këtij procesi.

Strategjia nacionale për bashkëpunim me diasporën ka financuar projekte përgjatë viteve 2019-2023, por si pasojë e pandemisë globale në vitin 2020 nuk është hapur fare konkurs dhe nuk është financuar asnjë projekt. IPP Arbën Xhaferi ka siguruar të dhëna edhe për projektet e realizuara përgjatë vitit 2018 kur nuk kishte ende strategji të miratuar, për të plotësuar boshllëkun e vitit 2020.

Projektet e vitit 2018

Në seancën nr. 75 të Qeverisë, të mbajtur më 19.06.2018, u mor vendim për miratimin e mjeteve nga Buxheti i vitit 2018 për financimin e projekteve me interes të pakicës kombëtare dhe diasporës të Maqedonisë së Veriut. Me këtë vendim janë ndarë **1.035.800 denarë (16.842 euro) për organizatat e diasporës (tabela 1).**

Shpërndarja e mjeteve është bërë në bazë të thirrjes publike të publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, si dhe në bazë të memorandumit për bashkëpunim të nënshkruar më 11.06.2018 në Shkup, ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme, përfaqësuar nga ministri i Jashtëm i atëhershëm, Nikola Dimitrov, dhe ministrit pa portofol për Diasporën, Edmond Ademi.

Fondet e miratuara kishin për qëllim financimin e gjithsej 12 projekteve, nëntë prej të cilëve janë realizuar, ndërsa tre nuk janë realizuar. Shuma e 9 projekteve të realizuara është 763.500 denarë (12.414 euro), buxhet që është shfrytëzuar në tërësi. Ndërkaq, shuma e tre projekteve të pa realizuara është 272.300 denarë (4.443 euro).

Nga 12 projektet e përzgjedhura, 11 ishin nga organizata apo persona fizik me përkatësi maqedone dhe vetëm një shqiptar, i cili projektin e kishte të fokusuar në hapjen e një portali në gjuhën maqedone, MKDNEWS.de si faqja e parë e këtij lloji në territorin e Gjermanisë. Qëllimi kryesor i të gjitha projekteve të financuara ka qenë promovimi, ruajtja e gjuhës, kulturës, dhe traditës maqedone. Në vitin 2018, asnjë projekt i vetëm nuk ka përkrahur aktivitete për komunitetet tjera përpos atij maqedon.

Projektet e vitit 2019

Programi për financimin e projekteve në fushën e diasporës për vitin 2019 nr. 44-11371/1-18, në pajtim me memorandumimin për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe ministrit pa portofol përgjegjës për diasporën, financoi 41 projekte të përzgjedhur në kuadër të thirrjes publike të publikuar nga Ministria e Punëve të Jashtme (**tabela 2**).

Shuma e përgjithshme e financuar ishte prej 92.493 euro, e ndarë si vijon: 64.033 euro, 911.450 denarë, 4.500 dollarë australianë, 4.500 dollarë amerikanë, 8.700 dollarë kanadezë dhe 720 funta britanike.

Prej 41 projekteve të përzgjedhura për vitin 2019, vetëm 4 projekte janë nga organizata apo persona fizik më përkatësi shqiptare (3 në Danimarkë dhe një në Rumani). **Vlera totale e 4 projekteve shqiptare është 9.100 euro, apo 9,8% e vlerës totale të fondeve**. Ndërkaq, 37 projektet tjera, apo 91.2% e fondeve, fokusohen në afirmimin e popullit, gjuhës, kulturës dhe traditës maqedonase, madje një numër prej tyre financojnë organizata fetare ortodokse.

Pra, përsëri, kemi të bëjmë me ndarje të fondeve mbi baza të pastërta etnike që shpien në diskriminim. Veç kësaj, ka dyshime për fondet që janë alokuar për tre projekte që nuk janë realizuar, dhe nuk është e qartë nëse fondet në fjalë janë transferuar dhe nëse po, nëse janë kthyer nga organizatat përfituese.

Disa projekte janë financuar për të dytin vit me radhë, siç është rasti i Samir Asanit (Gjermani), Redaksia e gazetës "PRESPA" në Shqipëri, Shoqëria Kulturore Maqedonase "Koço Racin", Obala dhe projekti "Ditët e kulturës maqedonase" në Slloveni.

Marrja e plotë e mbikëqyrjes së programit për shoqatat e diasporës nga ana e MPJ-së: 2020-2023

Organizatat e diasporës kanë rëndësi të madhe për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet diasporës dhe atdheut në nivel kombëtar dhe lokal. Përfshirja e tyre është faktori kryesor përcaktues për suksesin e këtij procesi. Sipas fragmentit të procesverbalit nga seanca e 21-të e Qeverisë, e mbajtur më 17 nëntor 2020, Qeveria ngarkoi Sekretariatit e Përgjithshëm që brenda 15 ditëve, të gjithë arkivin e kabinetit të ministrit pa portofol përgjegjës për diasporën, Edmond Ademi, t'ia dorëzojë MPJ-së, ndërsa institucioneve përgjegjëse për zbatimin e strategjisë u është kërkuar që raportet për punën e bërë për vitin 2020 dhe vitet në vijim t'i dorëzojnë poashtu në MPJ.

Në lidhje me të dhënat konkrete të kërkuara nga IPP Arbën Xhaferi, Sekretariati i Përgjithshëm, sipas njoftimit elektronik të shërbimeve të kabinetit të ministrit të Diasporës, në periudhën nga emërimi i Xhemail Çupit nga data 16.01.2022 deri në shkarkimin e tij më 23.02.2023, nuk ka

financuar projekte. Dokumentacioni i plotë lidhur me punën e ministrit të Diasporës e mori Ministria e Punëve të Jashtme.

Sipas përgjigjës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, në vitin 2020, për shkak të pandemisë COVID-19, nuk është hapur fare thirrje publike për projekte. Ndërkaq, për vitet 2021, 2022, 2023 MPJ-ja ka paraqitur të dhënat në vijim.

Projektet e vitit 2021

Në vitin 2021, MPJ-ja ka financuar tre projekte në vlerë totale prej **906.842 denarë apo rreth 14.745 euro**, dhe që të tre projektet ishin të realizuara nga shoqata e pakicës maqedone në Shqipëri (**tabela 3**). Për herë të parë nuk është financuar asnjë organizatë nga diaspora.

Këtu vërehet privilegjimi e gazetës “Prespa” e cila përsëri është përfituese e fondeve, sikurse në vitet paraprake. Poashtu, ajo që bie në sy është koncentrimi i projekteve krahasuar me vitete parapraken: ndërsa në vitin 2018 me 16.000 euro janë financuar 12 projekte, dhe në vitin 2019, me 64.000 euro janë financuar 41 projekte, me marrjen e kompetencave nga ana e MPJ-së, numri i projekteve zvogëlohet dukshëm, ndërsa rritet vlera e granteve individuale.

Projektet e vitit 2022

Në vitin 2022 MPJ-ja ka financuar 6 projekte në vlerë të përgjithshme prej **1.500.000 denarë apo rreth 24.390 euro**, të zbatuara vetëm nga shoqatat e pakicave maqedone në Shqipëri dhe në Serbi, me përjashtim të një projekti të zbatuar në Kinë nga një qytetare maqedone (**tabela 4**).

Edhe kësaj radhe, fokusi i vetëm i të gjitha projekteve ishte afirmimi dhe promovimi i identitetit dhe kulturës maqedone. Njëjtë sikurse më 2020, vërehet koncentrimi i madh i projekteve krahasuar me periudhën paraprake, me pak projekte të financuar në nivel më të lartë.

Projektet e vitit 2023

Më 2023, MPJ-ja ka financuar 23 projekte në vlerë totale prej **2.142.000 denarë apo 34.829 euro (tabela 5)**. Sikurse në vitet paraprake nën udhëheqjen e MPJ-së, të gjitha projektet kanë për qëllim promovimin dhe ruajtjen e identitetit maqedon.

Nga 23 projekte të financuara, 14 prej tyre janë projekte të fokusuar në ruajtjen e identitetit të pakicave maqedone apo gorane në vendet fqinje, si Shqipëria, Kosova dhe Serbia. Kësaj radhe megjithatë, janë financuar 9 projekte në vende ku jeton diaspora, por që të gjitha nga organizata apo persona fizik me përkatësi maqedone.

KONKLUZION

Organizatave të diasporës luajnë një rol tejet të rëndësishëm për vendosjen e bashkëpunimit ndërmjet diasporës dhe shtetit amë, duke filluar nga zhvillimi ekonomik e deri te arsimit dhe kultura. Mbështetja e tyre nga institucionet shtetërore është faktor kyç që përcakton suksesin e zbatimit të strategjisë shtetërore për diasporën.

Në këtë rrafsh, politikat e qeverisë së Maqedonisë së Veriut kryesisht kanë injoruar shoqatat e diasporës nga shteti që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut. Për më tepër, politika e qeverisë ndaj diasporës ka qenë çështje thellësisht e politizuar për shkak të strukturës kombëtare të diasporës, e dominuar nga shqiptarët. Për pasojë, deri më 2019 Qeveria nuk ka miratuar asnjëherë ndonjë udhërrëfyes politik për të mbështetur diasporën dhe për të shfrytëzuar potencialin e saj në zhvillimin socio-ekonomik të vendit.

Në mungesë të një strategjie shtetërore për diasporën, në vitin 2018, qeveria financoi 12 projekte në vlerë totale prej 16.842, por që të gjitha të fokusuar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit maqedon në vendet ku jeton diaspora.

Me miratimin e strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën (2019-2023), në vitin e parë të zbatimit të saj (2019), nën udhëheqjen e ministrit për diasporë pa portofol, Edmond Ademi, niveli i përkrahjes financiare u rrit në 92.493 euro, për 41 projekte, shumica dërmuese prej të cilëve ishin përsëri të fokusuar në ruajtjen dhe promovimin e identitetit maqedon në vendet ku jeton diaspora dhe në masë më vogël, në vendet e rajonit ku jetojnë pakica maqedone. Megjithatë, 4 organizata apo persona fizik me përkatësi kombëtare shqiptare u financuan me vlerë totale prej 9.100 euro (9,8% e totalit).

Gjërat ndryshuan për së keqi më 2020 me ardhjen e Bujar Osmanit në krye të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe marrjen e përgjegjësisë nga kjo e fundit për projektet me organizatat nga diaspora.

Përveç se u ul niveli total i financimeve për shoqatat e diasporës, ndodhi edhe një spostim i fokusit gjeografik të programit nga vendet ku jeton diaspora drejt vendeve të rajonit ku jetojnë pakicat maqedone dhe gorane. Rrjedhimisht edhe fokusi tematik i programit u spostua nga përkrahja e shoqatave të diasporës në përkrahjen e shoqatave për ruajtjen dhe promovimin e identitetit të pakicave maqedone dhe gorane në vendet fqinje. Ky fokus është i padobishëm dhe kundër frymës së strategjisë për diasporën sepse pakicat maqedone që jetojnë në vendet fqinje nuk janë të rrezikuara nga asimilimi, për dallim prej mërgimtarëve që jetojnë në vende të largëta si SHBA, Kanadë, Australi, në vendet tjera evropiane, të cilët kanë nevojë të lidhen me vendlindjen përmes projekteve të tilla.

Për pasojë, nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme, programi për shoqatat e diasporës u bë monoetnik maqedon dhe shoqatat shqiptare nga diaspora u përjashtuan totalisht nga zbatimi i strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën (2019-2023). Shqiptarët, që

përbëjnë 66,36% të diasporës së Maqedonisë së Veriut nuk përfituan as edhe një qindarkë nga programi për shoqatat e diasporës; maqedonët me 24,45% të përfaqësimit në diasporë shfrytëzuan 100% të fondeve të alokuara nga MPJ, me synim të ruajtjes së vlerave kulturore, artistike, gjuhësore maqedone.

Këto fakte dëshmojnë për një etnocentrizëm të skajshëm maqedon dhe një diskriminim të komuniteteve tjera që jetojnë në diasporë në zbatimin programit për shoqatat e diasporës. Për ironi, diskriminimi më i madh i shoqatave shqiptare nga diaspora ka ndodhur në kohën kur një ministër shqiptar, Bujar Osmani, ka udhëhequr me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

REKOMANDIME

- ◆ Konkursset dhe ndarja e fondeve në kuadër të programit për shoqatat e diasporës duhet të bëhen në mënyrë publike, me kritere të njëjta për të gjithë aplikuesit
- ◆ Në komisionet për përzgjedhjen e projekteve duhet të ketë përfaqësues të të gjitha komuniteteve si dhe shoqata nga diaspora.
- ◆ Shpërndarja e fondeve duhet të marrë parasysh strukturën demografike të diasporës, bazuar në rezultatin e regjistrimit të popullsisë 2021.
- ◆ Fokusi kryesor gjeografik i programit për shoqatat e diasporës duhet të jetë mbi të gjitha në vendet ku jeton diaspora e jo në vendet e rajonit ku jetojnë pakicat maqedone apo gorane, të cilat realisht nuk hynë në kategorinë e diasporës.
- ◆ Duhet të realizohet fushatë masive për informim të shoqatave të diasporës dhe të mërgimtarëve për mundësitë e financimit në kuadër të programit për shoqatat e diasporës.
- ◆ Duhet të rritet buxheti i programit për shoqatat e diasporës së paku në 200.000 euro na baza vjetore dhe financimi të jetë më afatgjatë dhe më i parashikueshëm në mënyrë që të lehtësohet veprimtaria e shoqatave.
- ◆ Duhet të rritet transparenca rreth realizimit apo mos realizimit të projekteve, rezultateve të arritura dhe impaktit të programit, duke u publikuar një raport vjetor nga ana e MPJ-së i cili duhet të jetë publik dhe i qasshëm për publikun.

ANEKSE

Tabela 1: projektet e financuara në vitin 2018

| Shteti: | Marrësi fondeve: | Projekti: | Shuma në denarë: | Realizimi: |
|----------------------|--|---|------------------|--------------|
| Shqipëri | Gazeta Albania Prespa-Eftim Mitreski, Spase Mazenkoski, f. Leska Pustec | Botim i gazetës Prespa për komunitetin maqedonas në Shqipëri | 221.500 denarë | Realizuar |
| Bosnjë – Hercegovinë | Shoqata e qytetarëve të Bosnjë-Hercegovinës me origjinë nga Maqedonia dhe Sarajeva | Këndi kulturor maqedonas dhe hapja e një faqe interneti (të bashkuar) | 61.500 denarë | Realizuar |
| Sloveni | Shoqëria Kulturore Maqedonase "Koço Racin", Obala | Ditët e kulturës maqedonase | 37.000 denarë | Realizuar |
| Gjermani | Mitko Jovanov | Mësimi online i gjuhës maqedonase në diasporë | 61.500 denarë | Realizuar |
| Britani e Madhe | Shoqata e Maqedonasve në Mbretërinë e Bashkuar | Shoqëria Kulturore-Artiste Maqedonase Sonce nga Londra | 141.500 denarë | Pa realizuar |
| Australi | Snezhana Dimitrovska në emër të Forumit për Maqedoninë Demokratike, Kanberra | Mbjellja ceremoniale-diplomatike e fidanëve nga Maqedonia në Arboretumin Ndërkombëtar në Kanberra | 39.500 denarë | Pa realizuar |
| Australi | Forumi i Maqedonisë Demokratike - dega për Australi | Mbrëmje me tekste dhe muzikë nga Maqedonia, "Qëndro përgjithmonë afër meje" | 91.300 denarë | Pa realizuar |
| SHBA | Aneta Georgeska - Shain | Ndërtimi i urave ndërmjet vendeve të Ballkanit – panel diskutimi | 31.500 denarë | Realizuar |
| SHBA | Aneta Georgeska - Shain | Trashëgimia kulturore e Maqedonisë - Perspektiva historike | 28.800 denarë | Realizuar |
| Gjermani | Samir Asani BREMEN | Hapja e web portalit të ri në gjuhën maqedone | 153.800 denarë | Realizuar |
| Malta | FDM - Maltë | Ajo jam unë dhe askush tjetër | 106.400 denarë | Realizuar |
| Mali i Zi | Shoqata e miqësisë malazeze- | Maqedonia bashkohet | 61.500 | Realizuar |

| | | | | |
|--|----------------------|--|--------|--|
| | maqedonase "Kirjana" | | denarë | |
|--|----------------------|--|--------|--|

Tabela 2: projektet e financuara në vitin 2019

| Shteti: | Marrësi fondeve: | Projekti: | Shuma në denarë: | Realizimi: |
|----------------------|---------------------------------------|---|------------------|--------------|
| Shqipëri | Shoqëria Maqedonase Ilinden Tiranë | "Gazeta maqedonase Ilinden" | 153.750 denarë | Realizuar |
| Gjermani | Samir Asani - Bremen | "Portali ekzistues online në gjuhën maqedonase në Gjermani" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Kosovë | Komuniteti maqedono-goran i Kosovës | "Botimi i një buletini të bashkësisë maqedonase të Kosovës-Gorocvet" | 141.450 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shkolla e mesme Pustec | "Le të njoftojmë miqtë tanë të shkollës" | 30.750 denarë | Pa realizuar |
| Rumani | Baki Imeri | "Prania e shqiptarëve nga Maqedonia e Veriut në Rumani" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Bosnjë - Hercegovinë | ZG Ilinden | "Ditët e kulturës maqedonase në Tuzla dhe zhvillimi i faqes së internetit të ZG" | 83.824 denarë | Realizuar |
| Gjermani | Ana Smillevska | "Unë hulumtoj, mësoj dhe miqësohem me atdheun tim, RMV" | 185.000 denarë | Realizuar |
| Zelanda e Re | Komuniteti maqedonas në Zelandën e Re | Blerja e kostumeve popullore maqedonase" | 277.000 denarë | Realizuar |
| Danimarkë | Ixhet Lutfiu | "Film dokumentar, Zëri i Shqiptarëve në Danimarkë" | 159.900 denarë | Realizuar |
| Danimarkë | Bardhyl Islami | "Revista elektronike aktuale" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Danimarkë | RTV ZËRI, përmes Adnan Alitit | "Ditët e Kulturës Shqiptare në Danimarkë" | 153.750 denarë | Realizuar |
| Kroaci | Gjimnazi i parë i Zagrebit | "Takimi i gjashtë i miqësisë i gjimnazit të parë Zagreb dhe Shën Kliment Ohridski nga Ohri" | 178.350 denarë | Pa realizuar |

| | | | | |
|----------|---|--|-----------------|--------------|
| Sloveni | Perlat e Ohrit MKD | "Ylberi" | 172.000 denarë | Realizuar |
| Kroaci | Perlat e Ohrit MKD | "Mbajtja e manifestimit tradicional Dita e Racinovit-Beli Mugri" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Sloveni | MKD Koço Racin, Obala Koper | "Ditët e kulturës maqedonase" | 153.000 denarë | Realizuar |
| Sloveni | Kisha e Shën Kirilit dhe Metodit, Kranj | "ETNO-FOLK Kranj 2019" | 73.800 denarë | Realizuar |
| Sloveni | Kisha e Shën Kirilit dhe Metodit, Kranj | "Art multilateral, Kranj 2019" | 79.950 denarë | Realizuar |
| Sloveni | Kisha e Shën Kirilit dhe Metodit, Kranj | "Presser valle, Kranj 2019" | 61.500 denarë | Realizuar |
| Sloveni | Despina Atanasova | "Afirmimi i gjuhës, kulturës dhe traditës maqedonase" | 153.750 denarë | Realizuar |
| Francë | Elena Golomeova | "Lejleku Siljan rrugës për në Francë" | 246.000 denarë | Realizuar |
| Kanadë | Pobeda Piskaçeva | Filmi dokumentar "Birthright Macedonia" | 180.230 denarë | Realizuar |
| Australi | Rinia Ortodokse Maqedonase e Australisë | "Uebfaqja e Rinisë Ortodokse Maqedonase" | 52.142 denarë | Pa realizuar |
| Kanadë | Virginia Andrew Evans | Festivali i Filmit Maqedonas | 226.316 dollarë | Realizuar |
| Maltë | Igor Filevski | "Radio emitim maqedonasit maltezë" | 184.500 denarë | Realizuar |
| Australi | Shoqëria letrare maqedonase "Vanço Nikoleski" | "Të ruajmë dhe të ushqejmë gjuhën maqedonase/konkursi për poezi dhe prozë" | 115.456 denarë | Realizuar |
| Romani | Angella Apostolovska | Dokumentar për vllahët maqedonas në Rumani me titull "Autostrada e suksesit" | 246.000 denarë | Realizuar |
| Holandë | Ivana Kungullovska | Arti i maqedonasve në Holandë | 172.200 denarë | Realizuar |
| Maltë | Zhivanka Mitanova | | | Realizuar |

| | | | | |
|-----------------|---|---|----------------|-----------|
| | | "Turizmi, tradita dhe kultura maqedonase në ujërat e Mesdheut" | 159.900 denarë | |
| Itali | Shoqata Kulturore, MAKITTURK SKUDRINJE | "Promovimi i kulturës, traditës dhe sportit maqedonas, afrimi, shkëmbimi i përvojave" | 92.500 denarë | Realizuar |
| Itali | Shoqata e Maqedonasve, Sun-Sole, Piacenza | "Veshjet popullore maqedonase nga trevat e mërgimtarëve tanë" | 61.500 denarë | Realizuar |
| Britani e Madhe | Boban Stoimenovski | "Film dokumentar Kishat në Maqedoninë Lindore" | 51.445 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata "Dielli" | "Dielli" | 31.000 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Redaksia e gazetës "PRESPA" | Redaksia e gazetës "PRESPA" | 154.000 denarë | Realizuar |
| Kroaci | MPO "Shën Zllata Meglenska" | "Ndërtimi i qendrës shpirtërore dhe kulturore të maqedonasve në Zagreb" | 61.500 denarë | Realizuar |
| Serbi | Perlat maqedonase | "Blerja e kostumeve maqedonase" | 61.500 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve "Kiril Pejcinoviq" | "Këndi maqedonas për fëmijë në banjën Kraljevë dhe Vrnjačka" | 61.500 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve të Maqedonisë - Jabuka | "Ruajtës të traditës përmes këngës dhe aktrimit" | 92.250 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve nga MNM "Kiril dhe Metodij" | "Ditët e kulturës maqedonase në Novi Sad" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Serbi | Fondacioni për zhvillim dhe promovim të kulturës maqedonase "Dielli i Maqedonisë" | Festivali i Kulturës Maqedonase "Subotica 2019" | 123.000 denarë | Realizuar |
| Serbi | Forumi i të rinjve maqedonas në Serbi | Këndi kulturor i të rinjve maqedonas në Beograd | 73.800 denarë | Realizuar |
| Serbi | ZGMNZ Ilinden – Jabuka | "Hapja e këndit maqedonas në qytetin e Jabukës" | 47.355 denarë | Realizuar |

Tabela 3: projektet e financuara në vitin 2021

| Shteti: | Marrësi fondeve: | Projekti: | Shuma në denarë: | Realizimi: |
|----------------|-------------------------------------|-----------------------------------|-------------------------|-------------------|
| Shqipëri | Shoqëria aksionare "Ilinden" Tiranë | Gazeta maqedonase "Ilinden" | 440.446 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Bashkësia maqedonase në Shqipëri | Botimi i gazetës "Prespa" | 154.225 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata "Dielli" Korçë, Shqipëri | T'i njohim miqtë tanë të shkollës | 312.151 denarë | Realizuar |

Tabela 4: projektet e financuara në vitin 2022

| Shteti: | Marrësi fondeve: | Projekti: | Shuma në denarë: | Realizimi: |
|----------|---|--|------------------|------------|
| Shqipëri | Shoqata "Dielli" Korçë, Shqipëri | Botimi i shtypur dhe elektronik i gazetës "Makedonium" | 197.600 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata e qytetarëve "Ilinden" Jabuka | Pajisimi dhe funksionimi i katit maqedonas në vendin Jabuka | 135.300 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata "Dame Gruev" Gornji Millanovac | Festimi i festës kombëtare të maqedonasve në Serbi, 2 gusht Ilinden 2022 | 82.718 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve MNM "Kirilli dhe Metodi" në Novi Sad | Manifestimi "Ditët e kulturës maqedonase në Novi Sad" | 177.736 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve maqedonas në Beograd "Makedonium" | Ditët e kulturës maqedonase në Beograd "Dopir na Makedonija" | 338.742 denarë | Realizuar |
| Kinë | Frosina Vitkovska | Publikimi i bashkëbisedimit me maqedono-kinezin në shqip dhe turqisht | 186.653 denarë | Realizuar |

Tabela 5: projektet e financuara në vitin 2023

| Shteti: | Marrësi i fondeve: | Projekti: | Shuma në denarë: | Realizimi: |
|----------|---|--|------------------|------------|
| Shqipëri | Shoqata maqedonase "Ilinden" Tiranë | Botimi i gazetës maqedonase "Ilinden" | 122.400 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata kulturore maqedonase "Dielli" Korçë | / | 122.400 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata kulturore maqedonase "Dielli" Korçë | Gazeta "Makedonium" në internet | 91.800 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata kulturore "Gora" Shqipëri | Organizimi i festivalit folklorik maqedonas "Folk Fest Gora 2023" | 91.800 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Shoqata maqedonase "Most" | Festa nacionale "Ilinden" | 91.800 denarë | Realizuar |
| Shqipëri | Komuniteti i maqedonasve në Shqipëri redaksia Prespa | Pulikimi i gazetës Prespa | 91.800 denarë | Realizuar |
| Kosovë | Komuniteti goran maqedonas Kosovë | Publikimi i gazetës së komunitetit maqedonas në Kosovë "Gorocvet" | 122.400 denarë | Realizuar |
| Kosovë | Komuniteti goran maqedonas Kosovë | Kurs në gjuhën maqedonase në Gorë, Kosovë | 122.400 denarë | Realizuar |
| Kosovë | Komuniteti goran maqedonas Kosovë | Organizimi i turneut tradicional maqedonas në futboll të vogël "8 shtatori 2023" | 122.400 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve të pakicës maqedonase për rrethin e Nishit | Kuiz për fëmijë "Njihuni me atdheun e prindërve dhe të parëve tuaj për ta dashur më shumë" | 91.800 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata kulturore artistike "Vasil Haxhimanov" Jabuka, Serbi | Paradë e lojërave popullore "Zhvillo vallen maqedonase" | 61.200 denarë | Realizuar |
| Serbi | ShQMBN "Vardar Vërshac" Serbi | Këndi maqedonas "Ringjallja e festave tradicionale" | 61.200 denarë | Realizuar |
| Serbi | Shoqata e qytetarëve maqedonas rrethi i Pçinjës, Vranjë Serbi | Emision televiziv "IFNOMAK" | 91.800 denarë | Realizuar |
| Serbi | Forumi i maqedonasve të rinj | Sermija për Aco Shopovin | 61.200 | Realizuar |

| | | | | |
|----------|--|---|----------------|-----------|
| | Pançevë, Serbi | | denarë | |
| Itali | Asociacioni Miqësi – Amiciza Itali, Ravena | Emission dokumentar Benvenuti in Italia | 153.00 denarë | Realizuar |
| Austri | Klubi i biznesit maqedonas austriak, Vjenë Austri | Këshilli për bashkëpunim ndërmjet RMV – Austri | 122.400 denarë | Realizuar |
| Turqi | Mustafa Kemal Uzunkaja | Internet radio në gjuhën maqedonase për muzikë dhe lajme për ngjarjet nga vendi | 30.600 denarë | Realizuar |
| Zvicër | Normat kulturzentrum , Bern Konfederata Zvicerane | Ditët e kulturës së RMV-së në Zvicër | 153.000 denarë | Realizuar |
| Australi | Snezhana Dimitrovska dhe Naum Trajçeski “Shoqëria letrare Vanço Nikoleski” Quenbeyan, Uells i ri Jugor, Australi | Konkurs i poezisë dhe prozës “Tarrajmë dhe kultivojmë gjuhën maqedonase” | 61.200 denarë | Realizuar |
| Kroaci | Bashkësia e maqedonasve, Zagreb | Dita e komunitetit maqedonas në Republikën e Kroacisë | 61.200 denarë | Realizuar |
| SHBA | Kalina dhe Nevena Neshkoska | “Darko Biberko” serial edukativ në youtube | 61.200 denarë | Realizuar |
| Rumani | Stojçeski Cele dhe Kukuneshoski Marjan, Bukuresht | Ditët e ushqimit maqedonas në Rumani | 61.200 denarë | Realizuar |
| Gjermani | Këshilli qendror i maqedonasve në Gjermani | Forumi maqedonaso-gjerman për bashkëpunim të ngushtë ekonomik, kulturor dhe politik | 91.800 denarë | Realizuar |

Instituti për Politika Publike Arbën Xhaferi

E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org

Web: www.ipp-arbenxhaferi.org

Tetovska 33/2/7
1000 Shkup
Maqedonia e Veriut

**Strategjia për Bashkëpunim me Diasporën 2019-2023:
Etnocentrizëm i skajshëm maqedon në programin për shoqatat e diasporës**

Janar 2024